



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KESHILLI

Nr. 3787/5 prot.

Pogradec, më 29. 09 2023

VENDIM

Nr. 103, DATË 27 / 09 /2023

**PËR**  
**ZGJERIMIN E SIPËRFAQES SË VARRËZAVE PUBLIKE PËR QYTETIN NË**  
**FSHATIN GURRAS DHE BLERJEN E SIPËRFAQES SE TOKËS SË NEVOJSHME**  
**PËR FUNKSIONIMIN E KËTIJ SHËRBIMI.**

Bazuar në ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 8, pika 1, neni 9, pika 1.2., gërma a) dhe c), neni 23, pika 7, neni 54, gërma k), neni 64, gërma gj), Ligji 80/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9220 datë 15.04.2004 Për shërbimin publik të varrimit", neni 4 pika 2, neni 5, pika 3d; ligjit nr. 8743, datë 22/02/2001, "Për pronat e paluajtshme të Shtetit", i ndryshuar, neni 5, ligji nr. 162/2020, "Për prokurimin Publik", neni 7, pika 1, gërma a), Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë nenet 83, neni 164, titulli II kontrata të vecanta, kreu 1 shitja, neni 705 e vijues me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**VENDOSI:**

1. Shtrirja e sipërfaqes së varrezave të reja publike për qytetin me vëndndodhje në fshatin Guras duke shtuar një sipërfaqe totale prej 6.590 m<sup>2</sup>, sipas hartës bashkangjitur.
2. Blerjen nga ana e Bashkisë Pogradec e pronave të nevojshme për shtrirjen e varrezave të reja të qytetit me vëndndodhje Guras për pronat si më poshtë:
  - 2.1. Prona me nr. Pasurie 321/20, Zona kadastrale 1711, me sip. 800 m<sup>2</sup>.
  - 2.2. Prona me nr. Pasurie 321/21, Zona kadastrale 1711, me sip. 1.090 m<sup>2</sup>.
  - 2.3. Prona me nr. Pasurie 321/6, Zona kadastrale 1711, me sip. 1.000 m<sup>2</sup>.
  - 2.4. Prona me nr. Pasurie 321/25, Zona kadastrale 1711, me sip. 3.700 m<sup>2</sup>.
3. Çmimi I blerjes së sipërfaqes do jetë çmimi prej 366 lek/m<sup>2</sup> (Çmim I dakortësuar edhe me pronarët me referencë sipas procedurës për shpronësim publik shpallur me kërkesë nr. 476/8, datë 23/06/2023 për "Ndërtimin e rrugës lidhëse Pogradec-Drilon. Lot 2").
4. Autorizohet Kryetari I Bashkisë të nënshkruajë kontratat e shit blerjes së sipërfaqeve të mësipërme përpara noterit duke respektuar në përgjithësi kushtet e kontratës bashkangjitur këtij vendimi, sipas formateve të përcaktuara në ligjin nr. 110/2018 "Për Noterinë".
5. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe administrata e Bashkisë për kryerjen e procedurave ligjore për rregjistrim.
6. Ky vendim hy në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI